

# RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS



Për Kompaninë: **“SHABAN SPAHIJA” B.I.**, emrin tregtar: **„Mishtore DRENI“**

Titulli i Projektit: **Thertore për therjen e kafshëve të trasha dhe të imta të mishit dhe përpunimin e tij**

Zona Kadastrale: **Mirushë**

Ngastra kadastrale: **P-72310050-01176-0**

Vendi i quajtur: **Dubrava-Lumi**

Komuna: **Malishevë**

Aplikuesi i Projektit: **z. Shaban Spahija**

**Malishevë, Qershor 2025**

**Aplikuesi:**

**“SHABAN SPAHIJA” B.I.**

**Emrin tregtar: „Mishtore DRENI“**

***Me seli në Mirushë, Malishevë***

z. Shaban Spahija

Tel: +383 49 659 699

**Hartuesi i raportit:**

**Dr.sc. Edona Kabashi–Kastrati**

Eksperte e licencuar për VNM

Nr. Licencës së lëshuar nga MMPH:

70/17

Tel.: +383 49 655 661

E-mail: [edonak88@hotmail.com](mailto:edonak88@hotmail.com)

*Investitori:*

**“Shaban Spahija” B.I.**

*Hartuesi i Raportit:*

***Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati***

\_\_\_\_\_ v.v

\_\_\_\_\_ v.v

**Qershor, 2025**

Përmbajtja:

|                                                                                           |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b>1. HYRJE</b>                                                                           | 5  |
| <b>2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT</b>                                            | 6  |
| <b>2.1. Rregullativa ligjore</b>                                                          | 6  |
| <i>a) Dokumentacioni normativ</i>                                                         | 6  |
| <b>b) Dokumentacioni teknik</b>                                                           | 7  |
| <b>2.2. Metodologjia e punës</b>                                                          | 8  |
| <b>3. KARAKTERISTIKAT E LOKACIONIT DHE MJEDISIT</b>                                       | 9  |
| <b>3.1. Potencialet ekzistuese</b>                                                        | 9  |
| <b>3.2. Pozita gjeografike e lokacionit</b>                                               | 10 |
| <b>3.2. Popullata dhe Vendbanimet</b>                                                     | 13 |
| <b>3.3. Lidhjet e komunikacionit</b>                                                      | 14 |
| <b>3.4. Kushtet klimatike</b>                                                             | 15 |
| <b>3.5. Relievi</b>                                                                       | 15 |
| <b>3.6. Hidrogjeologjia</b>                                                               | 15 |
| <b>3.7. Pedologjia</b>                                                                    | 16 |
| <b>3.8. Ndërtimi gjeologjik i lokacionit</b>                                              | 17 |
| <b>3.9. Natyra dhe biodiversiteti</b>                                                     | 17 |
| <b>3.10. Bimësia dhe vegjetacioni</b>                                                     | 18 |
| <b>3.11. Bota shtazore – Fauna</b>                                                        | 18 |
| <b>3.12. Peizazhi</b>                                                                     | 18 |
| <b>3.13. Dukshmëria</b>                                                                   | 18 |
| <b>3.14. Ajri</b>                                                                         | 18 |
| <b>3.15. Uji</b>                                                                          | 19 |
| <b>4.0. PËRSHKRIMI I THERTORËS PËR THERJEN E GJEDHEVE TË TRASHA DHE TË IMËTA PËR MISH</b> | 19 |
| <i>Objektet e Thertorës</i>                                                               | 20 |
| <i>Skema 1. Skema e procesit teknologjik të therjes së gjedheve</i>                       | 21 |
| <i>Në linjat e procesit teknologjik kanë të instaluar makinerit si:</i>                   | 21 |
| <b>4.1 Metodatat e konservimit dhe përpunimit të mishit</b>                               | 22 |
| <b>4.1.1 Tymosja dhe tharja si mënyra të konservimit të mishit</b>                        | 22 |
| <b>4.2 Fazat e Procesit teknologjik</b>                                                   | 23 |
| <b>4.2.1 Qëndrimi i përkohshëm i gjedheve:</b>                                            | 23 |
| <b>4.2.2 Pushimi i Gjedheve:</b>                                                          | 24 |
| <b>4.2.3 Evidentimi i Gjedheve:</b>                                                       | 24 |
| <b>4.2.4 Therrja e Gjedheve:</b>                                                          | 24 |
| <b>4.2.5 Lirimi i gjakut</b>                                                              | 27 |

|                                                                                                              |           |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| 4.2.6 Rrjepja, heqja e kokës dhe largimi i pjesëve tjera të gjedhit të cilat konsiderohen si mbeturinë ..... | 28        |
| 4.2.7 Prerja/copëtimi dhe përpunimi .....                                                                    | 28        |
| 4.2.8 Ftohja dhe ngrirja e mishit .....                                                                      | 28        |
| 4.2.9 Vulosja e mishit .....                                                                                 | 28        |
| 4.3 Përpunimi i mishit, përgatitja e suxhukut dhe mishit të terur:.....                                      | 29        |
| 4.4 Produktet e prodhuara nga kompania “SHABAN SPAHIJA”SH.P.K .....                                          | 30        |
| 4.4.1 Lëndet ndihmëse që shfrytezohen për zhvillimin e aktivitetit nga kompania .....                        | 30        |
| <b>5. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS .....</b>                                            | <b>31</b> |
| 5.1 Ndikimet në ajër .....                                                                                   | 32        |
| 5.2. Ndikimet në tokë.....                                                                                   | 32        |
| 5.3 Ndikimet në ujë.....                                                                                     | 33        |
| 5.4. Ndikimet nga zhurma .....                                                                               | 33        |
| 5.5. Ndikimet në florë dhe faunë .....                                                                       | 33        |
| 5.6 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë .....                                                               | 33        |
| 5.7 Ndikimi në mjedis në rastet aksidentale.....                                                             | 34        |
| <b>6.0 MASAT E MBROJTJES SË MJEDISIT .....</b>                                                               | <b>34</b> |
| 6.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër.....                                                           | 34        |
| 6.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë .....                                               | 34        |
| 6.3. Masat për mbrojtje nga zhurma .....                                                                     | 35        |
| 6.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peisazh, florë dhe faunë.....                                       | 35        |
| 6.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë .....                                      | 35        |
| 6.6. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore .....                                          | 36        |
| 6.7. Menaxhimi i mbeturinave.....                                                                            | 36        |
| <b>7.0. MONITORIMI DHE RAPORTIMI .....</b>                                                                   | <b>37</b> |
| 7.1. Monitorimi .....                                                                                        | 37        |
| 7.2. Raportimi .....                                                                                         | 37        |
| <b>8. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT .....</b>                                           | <b>37</b> |
| <b>9. KONKLUZIONE .....</b>                                                                                  | <b>38</b> |
| <b>10. LITERATURA.....</b>                                                                                   | <b>39</b> |
| <b>11. Shtojcë.....</b>                                                                                      | <b>39</b> |

## 1. HYRJE

Në kuadër të investimeve kompania “Shaban Spahija” B.I., me emrin tregtar „Mishtore DRENI“ nga Malisheva ka paraparë dhe hartimin e raportit mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis për aktivitetin që merret me therjen e kafshëve të trasha dhe të imta të mishit dhe përpunimin e mishit. Ky raport do të përfshijë në vete analizat e realizuara të ndikimeve të mundshme në mjedisin rrethues, duke përfshirë edhe botën e gjallë të lokacionit ku do të realizohet projekti i lartëcekur. Nevoja për përpunimin e mishit në Kosovë janë mjaft të mëdha pasi që edhe kërkesa për konsumin e mishit janë të mëdha, prandaj njëkohësisht është edhe mjaft profitabil, për këtë arsye pronaret e kompanisë “Shaban Spahija” B.I. me përfaqësues Shaban Spahija, me lokacion në Mirushë, Malishevë kanë hapur këtë mishtore – thertore për therjen e kafshëve të trasha dhe të imta të mishit dhe përpunimin e tij. Ky raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis është përgatitur për therrtoren e regjistruar si biznes individual “Shaban Spahija” B.I. dhe emrin tregtar „Mishtore DRENI“ me nr. të biznesit 811157933, me përfaqësues Shaban Spahija dhe trajton therjen kafshëve (gjedheve) dhe përpunimin e mishit. Raporti është hartuar në bazë të legjislacionit mjedisor të Republikës së Kosovës, në veçanti sipas Ligjit nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Për këtë qëllim investitori ka iniciuar hartimin e raportit të VNM-së për të identifikuar ndikimet e mundshme në mjedis, me qëllim të ndërmarrjes së masave të nevojshme për minimizimin e ndikimeve negative të mundshme në mjedis. Tereni ku është ndërtuar objekti është rrafësuar dhe hapësira-lokaliteti respektivisht zona ku është duke u realizuar projekti nuk i takon ndonjë zonë të mbrojtur të natyrës dhe në këtë zonë nuk ka ndonjë specie që është në rrezik për zhdukje, apo ndonjë zonë me rëndësi historike ose kulturore e cila do të mund të ndikohet me rastin e zhvillimeve të planifikuara lidhur me veprimtarinë e lartë përmendur. Raporti përshkruan gjendjen e përgjithshme në dhe rreth lokacionit të projektit, kushtet mjedisore ekzistuese, përshkrimin teknik të projektit që është realizuar, ndikimet e mundshme të projektit në mjedis, si dhe masat për parandalimin apo minimizimin e ndikimeve në mjedis. Identifikimi i ndikimeve potenciale në mjedis, identifikimi i masave për zbutjen e këtyre ndikimeve si dhe ndërmarrja e masave adekuate për të ndikuar në evitimin apo minimizimin e ndikimeve të këtij projekti në mjedis, janë komponentët kryesorë të këtij raporti.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis për kompaninë “Shaban Spahija” B.I. nga Malisheva, me pronar z. Shaban Spahija është hartuar, duke u bazuar në projektin e ndërtimit dhe funksionimit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit ku është duke u

realizuar aktiviteti i lartëcekur, dokumentit teknik ekzistues dhe në bazë të informatave të siguruara nga Ueb faqja e kumunës.

Në terren janë realizuar vizita në lokacionin e projektit, janë bërë matjet e nevojshme të lokacionit me GPS, është incizuar gjendja e terrenit dhe janë bërë fotografi për lehtësimin e përgatitjes së këtij raporti. Raporti është punuar në bashkëpunim të ngushtë me investitorin, prej të cilit janë marrë të dhënat kryesore dhe të nevojshme përmes bisedave. Veprimtaria e therjes se gjedheve dhe kafshëve te imta, parimisht vlerësohet se do të ketë vlerësim minimal në mjedis, ndërsa një ndikim më të madhe mund të kenë në ujëra. Ngritja respektivisht zhvillimi i kësaj veprimtarie pa dyshim se do të ndikon pozitivisht në të mirë të krijimit të prodhimeve vendore si dhe në aspektin socioekonomik përmes krijimit të vendeve të reja të punës.

## **2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT**

Raporti i VNM-së përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti ambiental gjatë funksionimit kontinuel të thertorës për therjen e gjedheve të trasha, të imëta dhe përpunimin e mishit, atë:

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin gjer në kufijtë e lejuar.

### **2.1. Rregullativa ligjore**

#### *a) Dokumentacioni normativ*

Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis - VNM është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së. Ligji për VNM (Nr. 08/L-181) ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo menjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur. Fusha e administrimit të mbeturinave në Kosovë rregullohet përmes Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat. Qëllimi i këtij Ligji është mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit nga ndotja dhe rreziku nga mbeturinat, përmes administrimit të mirëfilltë (të qëndrueshëm) të mbeturinave, duke krijuar kushte për parandalimin dhe zvogëlimin e prodhimit të mbeturinave dhe rrezikshmërisë së tyre. Ligjet dhe aktet nënligjore më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e raportit të VNM-së

për therrtorën për therjen e gjedheve të trasha, të imëta dhe përpunimin e mishit, janë shfrytëzuar ligjet:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11
- Ligji Nr.08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nrr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji Nr.08/L-137 për Pyjet
- Ligji për mbrojtjen e ajrit Nr. 03/L- 160
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L- 025
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012

#### **Udhëzimet Administrative:**

- Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore;
- Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit Administrativ (Mmphi) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore
- Udhëzimi administrativ.Nr.30/2014 përkushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujrave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor
- Udhëzimi administrativ për administrimin e mbeturinave të rrezikshme (06/2008)
- Udhëzimi administrativ Nr. 20/2012 për export, import dhe transit të mbeturinave.

#### **b) Dokumentacioni teknik**

Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përveç eksperiencës profesionale në udhëheqjen e procesit gjatë funksionimit kontinuel të therrtorës për therjen e kafshëve (gjedheve) të trasha dhe të imëta të mishit dhe përpunimin e tij, dhe konsultimeve që janë bërë me ekspertët që udhëheqin aktivitetet në këtë therrtorë, janë shfrytëzuar:

- Çertifikata e biznesit
- Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme
- Kopja e planit të parcelës,
- Situacioni i terrenit
- Pëlqimi/njoftim komunal, komuna e Malishevës

Krahas parashikimeve themelore nga regullativat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit janë shfrytëzuar edhe regullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi. Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërhënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis si që është direktiva e VNM-së, si dhe direktiva për mbeturinat.

## 2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis të thertores për therjen e kafshëve (gjedheve) të trasha dhe të imëta të mishit dhe përpunimin e tij, bëhet në disa faza edhe atë:

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet si që janë:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
- Popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- Karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin ku është e ndërtuar thertorës për therjen e kafshëve (gjedheve) të trasha dhe të imëta të mishit.
- Klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike.
- Kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë.
- Bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- Madhësia dhe lloji i ndotjes
- Karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- Gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- Vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse



c) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku është e ndërtuar thertorës për therjen e kafshëve (gjedheve) të trasha dhe të imëta të mishit.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kvantifikimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese.

Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që ka të bëjë me potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

### **3. KARAKTERISTIKAT E LOKACIONIT DHE MJEDISIT**

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke shtrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren. Për tu definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqëshme dhe për tu krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

#### **3.1. Potencialet ekzistuese**

Njëri nga elementet kyç të hulumtimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të lokacionit ku është e ndërtuar mishtorja-thertorja për therjen e kafshëve (gjedheve) të trasha dhe të imëta të mishit, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësit e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror siç janë toka, uji, ajri, relievi, flora dhe fauna. Secila nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit. Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është paraqitur në figurën 1.

Në bazë të raporteve të paraqitura në këtë figurë është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorisimit të ndikimit në mjedis ku është e ndërtuar thertorës për therjen e kafshëve (gjedheve) të trasha dhe të imëta të mishit dhe përpunimin e mishit, ndërtuar në hapësirën e lartcekur.




Fig.1. Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike.


### 3.2. Pozita gjeografike e lokacionit

Kompania ”Shaban Spahija” B.I./Mishtore DRENI nga Malisheva, e cila është duke operuar dhe planifikon të veproj edhe më tutje në lokacionin e quajtur “DUBRAVA-LUMI”, zona kadastrale Mirushë, komuna e Malishevës, në koordinatat gjeografike 42°29'21.25"N; 20°43'42.82"E. Lokacioni ndodhet në pjesën juglindore të Mirushës, ndërsa vet Mirusha shtrihet më shumë në veri-perëndim të Malishevës. Lokacioni ku ndodhet objekti i thertorës/mishtores ndodhet në afërsi të rrugës kryesore, përkatësisht në anën e majtë të rrugës Malishevë-Kijevë, që lidhë Komunën e Malishevës me fshatrat tjera të kësaj ane. Po ashtu ky lokacion nuk ndodhet shumë larg edhe nga qyteti meqë shtrihet në një distancë prej 1.3 km nga qendra e qytetit të Malishevës. Ndërsa në një distancë rreth 200m, në pjesën e pasme kalon Lumi Mirusha.


Komuna e Malishevës ka një sipërfaqe prej 306.3 km<sup>2</sup>. Ajo kufizohet në veri me komunën e Klinës dhe të Drenasit, në lindje me komunën e Lipjanit dhe të Therandës, në jug me komunën e Therandës dhe të Rahovecit, dhe në perëndim me komunën e Rahovecit dhe të Klinës. Qendra

komunale e Malishevës, si njësi administrative territoriale, përbëhet nga 39 njësi kadastrale dhe 44 vendbanime, përfshirë këtu edhe vetë qendrën komunale. Konfiguracioni i përshtatshëm i terrenit i mundëson komunës lidhje të mira të komunikacionit me të gjithë vendin. Me shumicën e qyteteve kryesore të Kosovës lidhet brenda një distance prej rreth 40-55 km, Gjakovë 40 km, Prizren 44 km, Prishtinë 49 km, Pejë 52 km, Ferizaj 56 km.

Lokacioni i therëtorës gjendet në anën e majtë të rrugës Malishevë-Klinë, në pjesën e ngastrëve kadastrale, fleta poseduese me nr. P-72310050-01176-0 me sip. 700 m<sup>2</sup> zona kadastrale Mirushë, komuna e Malishevës, në vendin e quajtur DUBRAVA-LUMI, lloji i shfrytëzimit të parcelës është **Pyjor**, shfrytëzimi aktual tokë pyjore, Mal i klasës 3, me sipërfaqe totale prej 700 m<sup>2</sup>. Pjesa e ngastrës **P-72310050-01176-0** është pronësi private e pronarit z. Shaban Spahija. Më poshtë mund të shihet më qartë lokacioni i terrenit përmes pamjes satelitore dhe hartës topografike të terrenit.







Harta 1. Hartat satelitore e terenit të thertores “Shaban Spahija” B.I.

Aktiviteti në fjalë është i përqëndruar në një parcel të vetme, ndërsa në parcelën ngjitur me të zhvillohet aktivitet tjetër. Lokacioni ku ndodhet dhe ku funksionon biznesi “Shaban Spahija” B.I,

përkatësisht therrtorja dhe mishtorja, ka kyqje direkte në rrugën Malishevë – Kijevë, në një vend ku kryesisht dominojnë aktivitete të ndryshme, e shëndrruar në një zonë industriale, me aktivitete sikurse autolarje, autoservise, pompë benzine, restorante, etj., por nuk mungojnë edhe shtëpitë e banimit të cilat nuk ndodhen në afërsi të drejtëpërdrejtë me objektin në fjalë.

Sipas natyrës së aktivitetit që zhvillohet në këtë lokacion nuk mund të konsiderohet si pengesë dhe i rrezikshëm për banorët e kësaj zone, nese respektohen të gjitha mastat higjenike – sanitare dhe ato për mbrojtjen e mjedisit. Poashtu nga këto të dhëna shihet se transporti rrugor është shumë i përshtatshëm.

Sipërfaqja e tërësishme e parcelës që përfshihet në këtë projekt është  $S = 700 \text{ m}^2$  e pjesës të ngastrës kadastrale me nr. **P-72310050-01176-0**, në të cilën është duke u zhvilluar dhe planifikohet të bëhet ushtrimi i aktivitetit, thertorja për therjen e kafshëve të trasha dhe të imta të mishit dhe përpunimi i tij, ku është e përkufizuar me kufijtë dhe koordinatat që janë të shënuara në dokumentacionin të cilin ia bashkangjesim raportit të VNM-së.

### **3.2. Popullata dhe Vendbanimet**

Vendndodhja e mishtores/thertorës në fjalë ndodhet në zonën kadastrale Mirushë komuna e Malishevës, në anën e majtë të rrugës e cila lidhë Malishevën me Kijevën dhe fshtatrat e kësaj ane si; Mirushë, Lubizhdë, Drenoc, etj. Në lokalitetin përreth kemi hasur edhe aktivitete tjera industriale të natyrave të ndryshme, të cilat kohëve të fundit kanë lulëzuar me masë të madhe, andaj edhe zona tërësisht ka destinim industrial. Ky projekt, do të jetë lehtësim për pronarin për funksionalizimin e veprimtarisë që tashme e ushtron. Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës është  $700 \text{ m}^2$ . Lokacioni është kryesisht i rrafshuar dhe përshtatur për objektin në të cilën realizohet veprimtaria e thertores dhe mishtores. Zona përreth pjesa më e madhe është e rrethuar nga industritë e ndryshme dhe rruga për vetura, ndërsa pjesa mbrapa objektit vazhdon me zonë malore-pyjore, e cila mund të shihet edhe nga pamja satelitore. Vendi se ku ndodhet impianti është paraqitur më mirë dhe më qartë në foton më lartë, marrë nga pamja satelitore. Në këtë zonë nuk ka dendësi të shtëpive të banimit, sikurse mund të shihet edhe nga fotot, ato shtrihen më në thellësi të fshatit dhe kjo për faktin e destinimit të zonës e cila është e karakterit industrial, por nuk mungojnë hapësirat banuese edhe në këto pjesë, por që janë më të rralla. Mbi objektin në fjalë banon vetë pronari i këtij biznesi. Infrastruktura është e përshtatshme, por prapë së prapë duhet marrë iniciativë nga vetë pronari për rregullimin e infrastrukturës. Njërin nga veçoritë qenësore të

hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, e paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorët që jetojnë në hapësirën e analizuar. Komuna e Malishevës në bazë të sasisë së ujit është një ndër vendet më pak të pasura. Kjo pozitë krijon parakushtete të vogla për zhvillimin e kulturave bujqësore, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe të turizmit.

Kushtet hidrologjike dhe kushtet natyrore të komunës së Malisheves ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë dhe për zhvillimin e aktiviteteve turistike dhe rekreative.

E gjithë kjo ka ndikim në strukturën ekonomike prandaj bujqësia dhe turizmi merret si pjesë madhore e aktiviteteve ekonomike në komunën e Malisheves dhe me gjerë.

Përmes anës së Malisheves kalon Autostrada “Ibrahim Rugova” e cila bashkon pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik me detin Adriatik.

Aktiviteti i therrtorës dhe mishtores “Dreni” në pikëpamje mjedisore, nuk do të ketë ndonjë ndikim relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi sepse një numër i popullatës mund edhe të përfitojnë nga ky aktivitet, duke u angazhuar me punë të përhershme dhe duke siguruar produkt të freskët dhe kualitativ.

### **3.3. Lidhjet e komunikacionit**

Lidhjet e komunikacionit janë shumë të mira me të gjitha rrugët e komunes së Malishevës. Zona ku ndodhet dhe ku funksionon Mishtore “Dreni” e planifikuar për therjen e gjedheve, lidhet përmes rrugës kryesore e cila lidh Komunën e Malishevës me Kijevën e cila pastaj do të Lidhet me Klinë në pjesën perëndimore përkatësisht me magjistralen Pejë - Prishtinë. Në afërsi të parcelës Zona e hulumtuar në aspektin e infrastrukturës rrugore lidhet me këto qendra mjaftë të rëndësishme të regjionit të Kosovës. Zona në fjalë është mjaft afër me qytetin e Malishevës dhe e përshtatshme për shërbim të shpejt dhe efikas për banorët e kësaj zone dhe më gjerë.

Sa i përket lidhjeve ndërkombëtare, kalimi i autostradës Durrës-Merdarë përmes territorit të komunës e vë Malishevën në pozitë të volitshme. Kjo autostradë mundëson lidhje të lehtë dhe të shpejtë me Shqipërinë dhe portin e Durrësit, ndërsa planet për vazhdimin e mëtutjeshëm të kësaj autostrade, si dhe ndërtimi i autostradës së re për Han të Elezit do të mundësojnë lidhje cilësore me shtetet dhe korridoret rajonale të transportit. Pozita e komunës së Malishevës ofron përparësi

edhe sa i përket vlerës dhe burimeve natyrore. Hapësira komunale e cila kufizohet me terrenet kodrinore në pjesën lindore (në kufi me Drenasin, Lipjanin dhe Suharekën) dhe në Jug-perëndim (që në kufi me Rahovecin), si dhe shtrirja e sipërfaqeve të rrafshëta në qendër, ofrojnë një larmi të përmbajtjeve dhe potencialeve bujqësore, mjedisore dhe biodiversitetit.

Pra, nga kjo që u cekë më lartë mund të konkludojmë se zona karakterizohet me lidhje të mira komunikimi, të cilat lidhje në të ardhmen do të rritin edhe më shumë vlerën ekonomike të kësaj zone, nga arsyeja se me lehtësi mund të realizohen punimet në impiant për realizimin e aktiviteteve të therrjës së gjedheve të trasha dhe përpunimin e mishit.

### **3.4. Kushtet klimatike**

Atmosfera është një sistem dinamik i cili vazhdimisht ndodhet në interaksion me komponentët e ndryshme të ndotjes. Si rezultat i interaksioneve mes komponenteve të ndryshëm mjedisor paraqitet ndotja sekondare, të cilat shprehen me ndryshimin e karakteristikave fizike të temperaturës, regjimit të dritës, sasisë së të reshurave dhe parametrave tjerë në plan lokal, ose ndryshime të mundshme edhe në planin global, por edhe potencimi me i madh i dëmit të të njëjtit përqëndrim të ndotjes, varësisht prej rrethanave të motit (psh: dukuria e inversionit të temperaturës). Vendi ku zhvillohet aktiviteti, është rajon i përshkruar me klimë të mesme kontinentale, me dimër relativisht të ftohtë, si dhe verë të nxehtë.

Temperaturat maksimale arrihen gjatë verës, mesatarisht  $+24.6^{\circ}\text{C}$ , ndërkah ato minimale shfaqen në janar, në vlera mesatare  $-10^{\circ}\text{C}$ . Të reshurat atmosferike sillen prej 511-1108 mm në vit.

### **3.5. Relievi**

Rajoni i gjerë i shtrirjes së lokacionit të therrtorës/mishtorës DRENI, në pjesën e majtë të rrugës Malishevë - Kijevë, karakterizohet me një reliev pak të pjerrët, por pjesa ku ndodhet objekti është rrafshuar dhe përshtatur për zhvillimin e aktivitetit sipas nevojave të saj.

### **3.6. Hidrogeologjia**

Karakteristikat hidrogeologjike të lokacionit janë të thjeshta. Morfologjia, ndërtimi gjeologjik, tektonika janë faktorët dominantë të cilët definojnë lëvizjen e ujërave sipërfaqësor dhe ato nën tokësor. Në aspektin hidrogeologjik zona ku do të realizohet projekti përbehet nga shkëmbinj gëlqeror dhe rreshpe që janë të përshkueshëm nga ujerat. Në pjesën e ngastrës ku është duke u realizuar ky projekt ujerat sipërfaqësore paraqiten vetëm gjatë të reshurave atmosferike, të cilat



drenohen në kanalet natyrale (prrockat) dhe pastaj drenohen në lumin Mirusha i cili ndodhet rreth 200 metra nga lokacioni i therrtorës.

Lumi kryesor që kalon nëpër komunën e Malishevës është Mirusha, i cili i takon pellgut të Drinit të Bardhë. Mirusha buron nga malet e Bllacës (masivi malor i Carralevës), ndërsa burimi përbëhet nga dy degë (përrenj): përroi që rrjedh nga Guncati dhe përroi që rrjedh nga Bllaca. Të dy këtë përrenj bashkohen në hyrje të fshatit Bellanicë për të krijuar lumin Mirusha. Në pjesën e poshtme të lumit Mirusha, në një gjatësi 2 km, është krijuar një grykë me 16 liqene lumore të madhësive të ndryshme, të lidhura me njëri-tjetrin me një ujëvara spektakulare me gjatësi prej 21 m (i dyti nga madhësia në Kosovë pas asaj në Radavc-Drini i Bardhë). Duke pasur parasysh vlerat mjedisore që Mirusha përmban në rrjedhën e saj dhe hapësirat përreth, zona rreth saj është shpallur Monument Natyror me Rëndësi të Veçantë.

Malisheva është e njohur edhe për burimin e ujit termal, i cili gjendet në fshatin Banjë, në anën e djathtë në lumit Mirusha. Në afërsi të këtij burimi është ndërtuar edhe pishina e hapur publike.

### **3.7. Pedologjia**

Në aspektin pedologjik, tokat në afërsi të lokacionit ku planifikohet të realizohet projekti bëjnë pjesë në tokat e pazhvilluara, me një shtresë të materialit fushor karakteristik për gëlqerorët. Kurse në largësi të ngastrave sidomos në ultësina (rrafshina) sipërfaqet ku janë të mbuluara nga tokat aluviale, deluviale janë toka me rentabilitet të lartë të kultivimit të kulturave bujqësore.

Kurse pjesët nga të cilat kemi një proces të alterimit të shkëmbinjve kemi toka që shumë pak shfrytëzohen tokë bujqësore, por ma tepër janë livadhore me vegjetacion të shumë të dobët të shkurreve dhe gjysmë shkurreve. Harta pedologjike e rajonit të ngushtë, ku zhvillohet aktiviteti i therrtorës/mishtorës DRENI është tokë ngjyrë kafet të cekët, lagështinë e marrin nga ujërat atmosferik. pH është bazike sidomos në vendburimin e gëlqerorit ku nga analizat kimike shihet se pH është 8 deri në neutrale sepse nuk kemi materie të shkëmbinjve acidikë. Përbërje ma të madhe të tokave kemi me ngjyrë të kuqe dhe kafe e ma shumë ato të smonicës. Tokat me ngjyrë kuqe në kafe janë biologjikisht mjaft aktive të cilat kryesisht përdoren si toka bujqësore dhe pyje të dytat kalojnë në smonica dhe vështirë përdorën për bujqësi. Masivet shkëmbore në dhe rreth zonës janë kryesisht të rreshpeve sericitike dhe serpentinitet.



### **3.8. Ndërtimi gjeologjik i lokacionit**

#### ***Ndërtimi Gjeologjik***

Në ndërtimin gjeologjik të rajonit marin pjesë shkëmbinj të moshave Jurasike, Kretake dhe Kenozoike

#### **Jurasiku**

**Kompleksi ofiolitik** – përfaqësohet nga facia ultrabazike, gabro, efuzive dhe shtroja metamorfike.

**Kompleksi i melanzhit tektonik** - Jurasik i mesëm dhe i sipërm, ndërtohet nga argjilite me blloqe dhe copa ranoresh, efuzivesh, rreshpe, silicore, radiolarite.

#### **Kretaku**

**Kretaku i poshtëm** përfaqësohet nga konglomerate, brekcie, ranorë, alevrolite, gëlqerorë algore

**Kretaku i sipërm** përfaqësohet nga Senomaniani, Turoniani dhe Koniakian - Santoniani.

#### **Depozitimet e pliocenit**

**Kompleksi liqenor i Pontianit** përbëhet nga depozitimet e nënpellgut të Bellanicës dhe ndërtohet nga argjila ranorike me ngjyre jeshile të errët, shtresa qymyore, argjila mergelore me fauna të shumta të species Anodonta dhe Ostracode, argjila mergelore dhe mergele me dominim të species Viviparus.

Ky kompleks është pjesë e pellgut liqenor të Dukagjinit, nënpellgu i Bellanices. Kompleksi liqenor mbyllet në pjesën e sipërme me argjila mergelore dhe argjila karbonatike me mbizotërim të faunave Congeria.

#### **Depozitimet kuaternare**

**Holoceni** – përfaqësohet nga depozitime aluviale tarracore të Holocenit të hershëm dhe depozitime aluviale, deluviale e eluviale të Holocenit të vonshëm.

### **3.9. Natyra dhe biodiversiteti**

Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë teren të afërt me lokacionin e thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimin e mishit kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë/territor që është potencial të futet nën mbrojtje. Ndërsa në distancë më të largët përkatësisht rreth 200m nga thertorja kalon lumi Mirusha.

### **3.10. Bimësia dhe vegjetacioni**

Në bazë të shqyrtimeve vizuale të zonës ku po realizohet aktiviteti i mishtores kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ultë barishtore, manaferra, shkurre, etj, kryesisht bimësi e llojeve që i përshtaten zonave të ndërtuara e banuara, me zhvillim industrial, ndërsa në arealin më të gjërë mund të shohet qartë që ka zhvillim të bimësisë, por që nuk është atakuar apo nuk preket nga aktiviteti në fjalë. Pjesa mbrapa hapësirës ku është ndërtuar objekti është i zhvilluar mali, përkatësisht bimësia pyjore, karakteristike për zonën dhe lartësinë mbideatre.

### **3.11. Bota shtazore – Fauna**

Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike si dhe në bazë të të dhënave nga vendasit në këtë zonë përpos kafshëve dhe shpezëve shtëpiake, jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, iriqi etj. Prej brejtësve – minjtë, prej zvarranikëve: gjarpërinjtë, breshka e tokës, zhapini i gjelbër etj, nga insektet: mizat, mushkonjat etj., dhe shpezë të ndryshëm karakteristike për këtë pjesë.

### **3.12. Peizazhi**

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin e realizimit të projektit–mjedisi.

Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive.

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

### **3.13. Dukshmëria**

Shikuar nga pozita e lokacionit ku po realizohet projekti dukshmëria është mjaft e lartë në të gjitha anët e horizontit. Vendet që shtrihen në këtë lokalitet karakterizohen më mjegulla dhe më lagështi të madhe të ajrit gjatë stinës së dimrit. Edhe kjo zonë nuk përjashton nga ky fenomen, por në masë më të vogël, sepse nuk ka kurrfarë uzine e as diçka tjetër që e rritë ndotjen e ajrit dhe për rrjedhojë e zvogëlon dukshmërinë.

### **3.14. Ajri**

Vegjetacioni i mirë, prania e madhe e llojeve të ndryshme të faunës janë treguesit kryesor për pastërtinë e ajrit. Kjo është zonë pranë rrugës, por e dominuar edhe nga pjesë pyjore, gjë që

kontribuon në pastrimin përkatësosht neutralizimin e ndotjes së ajrit. Ndotja e ajrit mund të ndodhë nga trafiku i cili zhvillohet në rrugën Malishevë-Kijevë. Mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë regjion është në nivel të lakmueshëm.

### **3.15. Uji**

Në këte lokacion ku është ndërtuar thertorja për therjen e gjedheve dhe përpunimin e mishit, kualiteti i ujit është i nivelit të mire, sepse në afërsi të lokacionit nuk ka ndotës potencial. Ndotja e ujit posaçërisht shkaktohet nga trafiku i cili zhvillohet në rrugën magjistrale Malishevë-Kijevë, dhe nga shpërlërja e trasës së rrugës me të reshurat atmosferike. Ndotja e ujit pjesërisht shkaktohet edhe nga stacionet e karburanteve të cilat janë të vendosura nga pranë rrugës dhe eventualisht nga komuniteti të cilët bëjnë shkarkimin e ujërave të zeza. Mund të konkludojmë se nga aktiviteti në fjalë nuk do të atakohen ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore.

## **4.0. PËRSHKRIMI I THERTORËS PËR THERJEN E GJEDHEVE TË TRASHA DHE TË IMËTA PËR MISH**

Mishi përfaqëson një nga produktet më të rëndësishme ushqimore në dietën e njeriut, për shkak të përbërjes së tij të pasur me proteina me vlerë të lartë biologjike, yndyrna, si dhe minerale esenciale, në veçanti hekuri (Fe). Megjithatë, për shkak të përbërjes së tij ushqyese, ai paraqet gjithashtu një substrat shumë të favorshëm për zhvillimin e mikroorganizmave, të cilët, në mungesë të trajtimit të duhur, mund të çojnë në dekompozim të produktit, dhe në raste të caktuara, në formim të substancave toksike për shëndetin e njeriut.

Parimi themelor i konservimit të mishit qëndron në pengimin (inhibimin) ose ngadalësimin e veprimtarisë mikrobike dhe enzimore, duke modifikuar kushtet mjedisore në mënyrë që të zgjatet jetëgjatësia e produktit dhe të ruhet siguria ushqimore.

Konservimi përfshin metoda të ndryshme si:

- **Ftohja dhe ngrirja**, që ngadalësojnë ndjeshëm aktivitetin mikrobik;
- **Kriposja**, e cila ndihmon në dehidratimin e sipërfaqës dhe krijon mjedis të pafavorshëm për mikroorganizmat;
- **Tharja**, që redukton ujin e lirë të disponueshëm për mikroorganizmat;
- **Përdorimi i konservantëve natyrorë ose kimikë**, sipas normave të lejuara;
- **Vakumimi dhe paketimi i modifikuar**, për të reduktuar kontaktin me oksigjenin dhe për të parandaluar oksidimin dhe zhvillimin mikrobik.


Në kuadër të mishtores dhe thertorës për therjen e gjedheve të trasha për mish dhe përpunimin e tij, kompania “Shaban Spahija” B.I. ka bërë gërryerjen dhe nivelizimin me zhavor të tërë hapësirës së thertorës dhe pastaj ka ndërtuar objektin i cili përbëhet nga:

### ***Objektet e Thertorës***

Përshkrimi i saktë i thertorës/mishtorës DRENI për therjen e kafshëve dhe përpunimin e mishit ka vetëm një objekt i cili është i ndarë si pas nevojës së shfrytëzimit dhe është i ndarë si në vijim:

1. Zyra e administratës
2. Hyrja e punëtorëve (ku behët edhe dezinfektimi i punëtorëve para se të hyjë në thertore)
3. Dhoma e ndërrimit të rrobave
4. Hapësira për therje të gjedheve
5. Dhoma për copëtim të gjedheve
6. Hapësira për mbajtjen e shënimeve
7. Dhoma e ftohjes 1, komore -2 deri +3 C
8. Dhoma e ftohjes 2, komore -30 C
9. Vendosja e mbeturinave të gjedheve
10. Shtalla për mbajtjen e bikave (përkohësisht)
11. Objekti për deponimin e lekurrave
12. Seperatorët e gjakut dhe yndyrës
13. Dhoma e shitjes

Sipas kapacitetit të projektuar është rreth 2-3 gjedhe në ditë. Ndërsa, kapaciteti i realizuar i therjes së kafshëve është 1-2 gjedhe në ditë varësisht nga sezona. Sasia e suxhukut të tharë është rreth 100 – 150 kg/javë. Sasia e mishit të tharë është rreth 40 – 50 kg/javë.



**Skema 1. Skema e procesit teknologjik të therjes së gjedheve**

***Në linjat e procesit teknologjik kanë të instaluar makinerit si:***

1. Boksi për therjen e gjedheve
2. Vinqat për mbajtjen pezull të gjedheve
3. Sharrat elektrike për copim të eshtrave dhe mishit
4. Frigoriferat për ruajtjen e mishit në temperaturë konstante
5. Makinat për bluarje të mishit
6. Mikserat për përzirje të mishit
7. Kompresorët
8. Peshoret
9. Furrat për tharje të mishit dhe suxhukut
10. Automjetet transportuese
11. Gjeneratorët

#### **4.1 Metodat e konservimit dhe përpunimit të mishit**

Metodat e konservimit të mishit janë të shumta dhe janë përdorur që nga lashtësia, kur njerëzit ruanin mishin përmes tharjes, kriposjes, etj. Sot, këto metoda janë përmirësuar ndjeshëm dhe janë bërë shumë më efektive. Konservimi i mishit dhe i nën-produkteve të tij realizohet përmes trajtimeve të ndryshme, si trajtimi termik (i cili përfshin tharjen), tymosja (e cila përveç tharjes i jep mishit edhe përbërës me veti aromatike dhe antioksiduese), si dhe ruajtja në temperatura të ulëta, që ngadalësojnë në maksimum proceset biologjike dhe mikrobike.

Një metodë më moderne është rrezatimi, i cili është shumë efektiv në shkatërrimin e mikroorganizmave si *Clostridium botulinum*, që prodhon toksina të rrezikshme. Megjithatë, kjo metodë është objekt debatesh dhe në disa vende nuk lejohet, për shkak të shqetësimeve mbi mundësinë e ndikimeve gjenetike tek konsumatori. Sidoqoftë, në doza të kontrolluara, rrezatimi nuk paraqet rrezik për shëndetin. Përpunimi i mishit përfshin transformimin e mishit të freskët nëpërmjet metodave si: pjekja, dehidratimi, konservimi, ngrirja, trajtimi në kushte me lagështi të ndërmjetme, si dhe përdorimi i aditivëve të ndryshëm si kimikatet dhe enzimat. Kështu, dallojmë dy kategori kryesore të përpunimit:

1. Proceset që synojnë ruajtjen afatgjatë dhe prodhimin e nënprodukteve të mishit;
2. Proceset që ndryshojnë formën dhe strukturën e mishit të freskët për qëllime përpunimi të mëtejshëm.

##### **4.1.1 Tymosja dhe tharja si mënyra të konservimit të mishit**

Tymosja është procesi i përpunimit të produkteve të mishit, kryesisht proshutave me tymi me djegje te plotë te drurit. Por, kuptimi teknologjik është me i gjerë. Ky proces bazohet në dukurinë e shpërhapjes dhe të osmozës. Gjatë tymosjes shpërhapja behet me dy drejtime. Dalja ujit nga prodhimi jashtë tij (dehidratimi). Pra, gjatë tymit në brendësi të produktit. Hyrja në brendësi behet ne dy faza. Ne fazën e pare komponimet e tymit grumbullohen në sipërfaqe te produktit ndërsa, në fazën e dytë për shkak të diferencës se përqendrimit midis shtresave fillon shpërhapja e kompozimeve nga jashtë brenda. Shpërhapja e njëlllojë e tymit varet nga:

**Temperatura dhe shpejtësia e lëvizjes së tymit.** Me rritjen e temperaturës dhe të shpejtësisë së lëvizjes së tymit rritet dhe shpejtësia e lëvizjes së tij ne produkt. Temperatura dhe shpejtësia e lëvizjes së tymit duhet të zgjidhet në varësi të llojit të sallamit që do të prodhohet. Në rast se ato rriten mbi kufijtë e lejuar rrezikohet dehidratimi i shtresave të jashtme të produktit duke shkaktuar

formimin e një koreje të thatë në sipërfaqe që pengon hyrjen e tymit. Përbërja cilësore e tymit. Kjo ndikon në shpërndarjen e njëllote të tij po edhe në cilësinë organoleptike të prodhimit të gatshëm. Përbërja e produktit. Shpejtësia e hyrjes dhe shpërndarjes së tymit në sallam varet nga përbërja e tij. Komponimet e tymit hyjnë me shpejt në indin dhjamor dhe me pak në lëkure dhe akoma më pak në indin muskolor. Sipas temperaturës së tymit dallohen 3 lloje tymosjesh:

**Tymosja e ftohtë** me temperaturë 20-30 °C. Kjo tymosje përdoret për sallamet dhe proshutat kurdo (vetëm të tymosura) dhe zgjat 2-7 ditë në varësi të prodhimit. Pas tymosjes kryhet stazhionim për 1-2 muaj.

**Tymosja e ngrohtë** dhe temperaturë 40- 50 °C. Kjo tymosje zbatohet për sallamet e tymosur dhe pah të pjekur. Koha e tymosjes zgjat 2-3 orë. Me këtë mënyrë tymosen edhe sallamet e zier dhe gjysme të tymosur. Koha e tymosjes zgjat 40 minuta.

**Tymosja e nxehtë** me temperaturë 60-80°C. Tymosja dhe tharja, siç shihet edhe nga informacioni i mësipërm e shprehin rolin e tyre si konservues në baze të uljes së aktivitetit të ujit por edhe duke i dhënë produkteve të trajtuara lende me efekt konservues (kryesisht tymi)

## **4.2 Fazat e Procesit teknologjik**

Procesi i cili zhvillohet në thertore ka një linjë; linja për thyerjen e kafshëve të trasha siç janë gjedhet. Thyerja e tyre bëhet në mënyrë mekanike, pra me dorë, ku gjatë procesit të punës nuk përdoret ndonjë teknologji e rënde dhe e sofistikuar. Ky proces me shumë i ngjanë mënyrave tradicionale të thyerjes së kafshëve. Me poshtë kemi bërë renditjen disa fazave sipas procesit të punës në thertorën “Shaban Spahija” B.I.

### **4.2.1 Qëndrimi i përkohshëm i gjedheve:**

Gjedhet e blera nga tregu vendor apo të importuar, sillen në objektin e thertoresh përkatësisht në shtallën e saj, për qëndrim të përkohshëm. Aty kafshët marrin ushqim dhe ujë, ndërsa qëndrimi i tyre aty është i shkurtër dhe mirë i planifikuar sipas kërkesave të tregut për mish dhe produktet e mishit. Gjithmonë gjedhet para se të vendosen në shtallë i nënshkrohen një kontrolli rutinor nga veterinari i kontraktuar nga thertorja.



#### ***4.2.2 Pushimi i Gjedheve:***

Gjedhet para së theren zakonisht pushojnë rreth 12 orë në hapësirat e shtallës dhe gjatë kësaj kohe atyre ju ofrohet ushqim dhe ujë për pije.

#### ***4.2.3 Evidentimi i Gjedheve:***

Numrat e gjedheve vendosën më qëllim evidentimin e tyre, në rast se ndonjë gjedhë është i sëmur apo diqka të ngjajshme, bëhet identifikimi i tij dhe kontrolla nga veterinari dhe marrja e vendimit nese ai gjedhë duhet ti nënshtrohet therjes apo jo. Therja nuk lejohet në rast se kemi ndonjë gjedh të sëmurë.

#### ***4.2.4 Therrja e Gjedheve:***

Therja e Gjedheve bëhet në mënyre mekanike, pra me dore, ku gjatë procesit të punes mund të përdoret ndonjë teknologji më e sofistikuar si sharrat për prerje, vinçat dhe boksta për mbajtje të gjedhit. Ky proces me shumë i ngjanë mënyrave tradicionale të therjes së kafshëve, pra sipas metodës Hallall për therrje. Pas therrjes fillon derdhja e gjakut, ku pastaj gjedhi në mënyrë vertikale kalon në pjesën tjetër të therrtorës ku bëhet kullimi i gjakut, ngritja e gjedhit bëhet në mënyrë profesinale me vinça të posaçëm elektrik.









#### ***4.2.5 Lirimi i gjakut***

Lirimi i gjakut të gjedheve të therura bëhet në hapësirën e veçantë për grumbullimin e gjakut dhe dërgimin e tyre në sepëratorët që janë të ndërtuar në oborrin e parcellës të therëtorës. Sepëratorët për grumbullimin e gjakut dhe ujit kanë një kapacitet të mjaftueshëm për grumbullimin e tyre. Sasia e gjakut që lirohet është rreth 4-5% të peshës trupore të gjedhit.

#### ***4.2.6 Rrjepja, heqja e kokës dhe largimi i pjesëve tjera të gjedhit të cilat konsiderohen si mbeturinë***

Pasi të bëhet therja e gjedheve, fillon procesi rrjepjes dhe largimi i mbeturinave të gjedheve. Pas kësaj gjedhet e prera kalojnë në sektorin e therrtorës ku bëhet copëtimi i tyre. Mbeturinat e kafëshëve hudhen në kontainer të veçantë dhe mërret nga kompanit e licencuara për grumbullimin e mbetjeve të kafshëve.

#### ***4.2.7 Prerja/copëtimi dhe përpunimi***


Në këtë fazë bëhet prerja e gjedhit në dy pjesë më anë të sharrës elektrike të posaçme për këtë veprimtari, në këtë fazë bëhet inspektimi i mishit nga inspektori përkatës i veterinarisë dhe dërgimi i mishit në frigorifetët fotohës për ruajtje.

#### ***4.2.8 Ftohja dhe ngrirja e mishit***

Pasi që mishit është shumë i ndjeshëm dhe shumë lehtë mund të priset. Ateherë, pas çdo preje të gjedhit mishit kërkon të vëndoset në frigorifer për ftohje në temperaturë rreth -0.5 deri në +4 °C. Pas kësaj faze të ftohjes mishit është i gatëshëm për shitje.

#### ***4.2.9 Vulosja e mishit***

Vulosja e mishit bëhet nga veterinarët, me të cilët deshmohet së mishit është i shëndoshë për konsum dhe mund të ju shitët konsumatorëve. Siç dihet një pjesë e mishit shitet si mish më asht, ndërsa në pjesa tjetër hiqet nga eshtart dhe përpunohet. Eshttrat e mbetur poashtu hudhen në kontinjer dhe pastaj merren nga kompanit e licencuara për grumbullimin e tyre.



*Fig. 3. Dhoma për shitjen e produkteve të mishit*

#### **4.3 Përpunimi i mishit, përgatitja e suxhukut dhe mishit të terur:**

Pasi kompania “Shaban Spahija” B.I. bënë edhe prodhimin e suxhukut dhe mishit të terur, ajo ka të instaluar në këtë therrtore edhe linjen për prodhim të suxhukut dhe mishit të tharë.

Më linjen e prodhimit të suxhukut bëhet grirja e mishit dhe mbushja e suxhukut. Ndërsa në linjën e tharjes bëhet edhe linja e tharjes së suxhukut dhe mishit. Tharja bëhet me ashkëla druri në dhomat/furrat e posaçme për këtë aktivitet.

Gjatë operimit të impianti për therje të gjedheve, gjenerohen edhe mbeturina që mbesin gjatë procesit të punës.

Mbeturinat të cilat mbesin janë mbetjet e gjedheve dhe mbeturinat të cilat i bënë personeli gjatë procesit të punës në thertorës. Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikën e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi.

Për largimin e këtyre mbeturinave kompania “Shaban Spahija” B.I ka marrëveshje me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave si kompani private për grumbullim të tyre.

Për mbetje të mundshme të këtij aktiviteti, zgjidhja është si ne vijim:

| Mbeturina                                                | Emri i mbeturinës                                                                                                                                                                                                       | Shkalla e rrezikshmërisë | Lloji i deponimit                                  |
|----------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|----------------------------------------------------|
|                                                          | Letra                                                                                                                                                                                                                   | Jo të rrezikshme         | Kontejner                                          |
| 13 01<br>13 02                                           | Vajra dhe lubrikante te perdorura                                                                                                                                                                                       | Te rrezikshme            | Bure                                               |
| 15 01 01<br>20 01 01<br>20 01 08                         | Mbeturinat e ngurta komunale                                                                                                                                                                                            | Jo te rrezikshme         | Kontejner për mbeturina                            |
| 02 02 07<br>02 02 02<br>02 02 03<br>02 02 04<br>02 02 99 | Llumrat që vijnë nga larja dhe pastrimi<br>Mbeturinat nga indet e shtazëve<br>Materiale jo të përshtatshme për konsumim dhe konzervim<br>Llumrat që rrjedhin nga vend trajtimi<br>Mbeturinat të pa specifikuara ndryshe | Të rrezikëshme           | Tek kompanitë e licencuara për grumbullimin e tyre |

→ Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina,

→ Mbeturinat e mbetjeve të gjedheve pas therjes, merren nga kompania që është e kontraktuar për këtë.

#### 4.4 Produktet e prodhuara nga kompania “SHABAN SPAHIJA”SH.P.K

Kompania “SHABAN SPAHIJA” SH.P.K merret me përpunimin dhe konservimin e mishit. Kapaciteti i saj aktual është deri në 10 krerë në javë, me një kapacitet përpunimi prej 80 kg/orë për suxhuk dhe 80 kg/orë për mish të tymosur.

Prodhimi aktual i këtyre produkteve realizohet në varësi të kërkesave të tregut, ndërsa kapaciteti i projektuar është:

- Deri në 100 kg/orë suxhuk,
- Deri në 10 kg/orë mish i tymosur.

#### Produktet finale të kompanisë janë:

1. Suxhuk i tharë dhe i tymosur
2. Mish i tharë dhe i tymosur
3. Mish i freskët (i cili shitet në pikat e shitjes)

#### 4.4.1 Lëndet ndihmëse që shfrytëzohen për zhvillimin e aktivitetit nga kompania

Kompania për ta zhvilluar aktivitetin e vet përdorë këto lëndë:

1. Uji - kompania ka hapur një pus për furnizim me ujë, gjithashtu është i lidhur në rrjetin e ujësjellsit.
2. Energjia elektrike furnizohet nga rrjeti i KEDS dhe Kes-Co.



3. Ndërsa për mbeturunitat inerte merren nga deponit vendore.

4. Aditivët të ndryshëm (kripa e kuzhinës, speci djegës, qepa, etj).

## **5. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS**

Vlerësimi i ndikimit në mjedis të thertores për therjen dhe përpunimin e mishit duhet të bëhet gjatë:

- Fazës së ndërtimit të objektit (aktualisht objekti është i përfunduar)
- Fazës së funksionimit dhe të
- Përfundimit të projektit

Therrtorja “Shaban Spahija” B.L., me aktivitet kryesor therjen, përpunimin dhe shitjen e mishit është e përkushtuar më të gjitha funksionet e saj organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm.

Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim:

- Përmirësimin e vazhdueshëm të Mjedisit
- Parandalimin e dëmtimit të Mjedisit
- Respektimin e legjislacionit vendor në fuqi
- Përmirësimin e komunikimit me autoritetet.

Investimi në ndërtimin dhe funksionalizimin e thertores së gjedheve, paraqet një kontribut mjaft të vlefshëm për produkte që ofron si dhe për mundësitë e punësimit. Ndërsa ndikimet (presioni) në mjedis domosdo se vijnë në shprehje kur vepron faktori antropogjen në mjedis, vetëm se në shkallë të caktuar duke filluar nga minimumi real i këtij ndikimi. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për të eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime. Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin ideor të konceptuar e të diskutuar më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku është duke funksionuar therrtorja. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit),



biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

### **5.1 Ndikimet në ajër**

Duke u bazuar në lokacionin ku është ndërtuar thertorja e cila është në periferi përkatësisht në fshatin Mirushë, Malishevë, nuk pritet të ketë ndonjë trysni në ajër për qytetin e Malishevës dhe rrethinës. Ndikimet në ajër mund të vi vetëm nga lëvizja e makinerive transportuese ku një numër i gazrave lirohen, nga pluhuri i cili mund të qohet pezull dhe nga mbetjet e kafshëve pasi janë therur.

Me gjithë këtë në bazë të pozicionit të thertores dhe procesit që do të zhvillohet në këtë thertore nuk pritet të paraqitet ndonjë tejkalimi i vlerave të ndotjes së ajrit, por edhe nuk priten të tejkalohen vlerat kufitare të kualitetit të ajrit sipas të OBSH (ky lokalitet apo tërë ky regjion në aspektin e cilësisë së ajrit qëndron mirë) dhe nuk priten përkeqësime lokale në cilësinë e ajrit në kuadër të lokalitetit të drejtpërdrejtë nga thertorja. Ndikimet në ndotjen e ajrit mund të vinë në raste të mos kujdesit për mbetjet e kafshëve pas therjes, ku mundet të vije deri të hedhja në ambient të hapur të mbetjeve të kafshëve, e si pasojë e saj mund të vije deri të ndotja e ajrit me aroma që liroheni këto mbetje. Zona në fjalë ku ndodhet mishtorja, ndodhet shumë pranë rrugës që lidh qytetin e Malishevës me Kijevën, andaj edhe ka fluks të veturave, të cilat mund të kontribuojnë në rritjen e nivelit të ndotjes së ajrit.

### **5.2. Ndikimet në tokë**

Aktivitetet që do të zhvillohen në këtë mishtore/thertore nuk do të kenë ndikim të madh në tokë, përveç atyre ndikimeve që kanë qenë në hapësirën e ndërtimit të objektit. Ndërsa jashtë parcelave të kompanisë ndikimet në tokë nuk do të ketë, marrë parasysh edhe zonën e cila qdo ditë po lulëzon nga ndërtimet e ndryshme, kryesisht të natyrës industriale, marrë për bazë edhe faktin që nuk ka ndonjë aktivitet që paraqet trysni anësore. Nga shkarkimi i ujerave pas procesit të therjes dhe përpunimit nuk do të ndodh ndotja e tokës pasi impiantit për therjen e kafshëve, kompania “Shaban Spahija” B.I. ka ndërmarrë të gjitha masat për evitimin e ndotjes së ambientit duke ndërtuar gropën septike për trajtimin e ujërave të ndotur. Ndërsa ndikime tjera si derdhje e vajrave etj, nuk ka.

### 5.3 Ndikimet në ujë

Në afërsi të kësaj zone nuk ka ndonjë rrjedhje apo grumbullim të ujërave sipërfaqësore që do të mund të ndikoheshin nga kjo therrtore. Ndotja e ujërave mund të vijë nëse, ujërat nga pastrimi i pajisjeve pas procesit të therjes shkarkohen në ujë rrjedha apo ujera nëntokësore. Gjatë operimeve, kualiteti i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktiviteti i impiantit për përpunimin e mishit mund të ndikohet në disa rrugë:

- Menaxhimi jo adekuat i ujërave të zeza, mund të rezultojë me depërtimin deri në ujërat nëntokësore.
- Menaxhimi jo adekuat i gjakut dhe mbetjeve të gjedheve.

### 5.4. Ndikimet nga zhurma

Si rezultat i natyrës së veprimtarisë së ushtruar në këtë thertore/mishtore të mishit nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në ngritjen e nivelit të zhurmës për mjedisin për rreth, e cila do të shqetësonte banoret e kësaj zone. Thertorja punon vetëm me një ndërrim të rregullt prej 8 orësh, prandaj kjo është edhe e favorshme për fabrikën në lidhje me zhurmën, pasi në këtë orar qytetaret janë aktiv thuaj se të gjithë dhe zhurma është edhe me pak e ndjeshme.

### 5.5. Ndikimet në florë dhe faunë

Në këto zona të rajonit rriten llojet me të zakonshme të florës dhe faunës. Zona përreth ku është duke ushtruar aktivitetin e thertorja, është zone e banuar nga banoret dhe kryesisht me objekte industriale, prandaj nuk do të ketë ndonjë ndikim të madh në florën dhe faunën. Gjithashtu, në këtë lokacion e as në zonën më gjerë deri më tani nuk është evidentuar ndonjë habitat i veçantë i llojeve të botës bimore apo shtazore. Edhe pse ky aktivitet nuk paraqet ndonjë rrezik specifik në florën dhe faunë.

### 5.6 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Hapësira ku gjendet thertorja nuk ka ndikim negative në popullatën e zonës, pasi që nuk ka pasur nevojë të zhvendoset ndonjë shtëpi, nuk do të bëjë ndonjë trysni gjatë operimit të saj dhe nuk krijon shqetësim për banorët lokal. Në të kundërtën ka ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në mbështetje përmes punësimit të komunitetit lokal, njëkohësisht sjell produkte të sigurta të mishit në tregun e Malishevës dhe komunave për rreth dhe të Kosovës në përgjithësi.

### 5.7 Ndikimi në mjedis në rastet aksidentale

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve të impiantit të thertores vlerësohen si raste të izoluara. Nuk ka aktivitete me materiale të rrezikshme të cilat paraqesin potencial të lartë për rrezikimin e shëndetit të njeriut apo mjedisit në përgjithësi.

## 6.0 MASAT E MBROJTJES SË MJEDISIT

### 6.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për zvogëlimin e ndotjes së ajrit nga impianti për therjen e gjedheve, duhet që operatori në fjalë të mirëmbaje dhe ujite në mënyrë të vazhdueshme sipërfaqen e tokës ku operon në mënyrë që të mos krijohet pluhuri, duhet të i kushtohet rëndësi edhe pajisjeve makinerike që përdoren për transport që të mos të lirojnë gazra e me këtë të ndotet ajri, mirëpo ato të mirëmbahen në mënyrë të rregullt, të mos lihen të ndezura pa nevojë e të lirojnë gazra dhe të trajtohen mbetjet e kafshëve (pasi që janë therur) në mënyrë adekuate. Mirëpo nga procesi i therjes së kafshëve, mund të themi lirisht se ndotja e ajrit është minimale kur merret parasysh procesi që do të zhvillohet në të. Megjithatë gjatë operimit do të merren masat:

- Mirëmbajtje e hapësirës së impiantit për therje,
- Mirëmbajtjen e rregullt të makinerisë së punës dhe makinerisë lëvizëse-motorike.
- Kompania në fjalë ka ndërmarre të gjitha masat për evitimin e ndotjes së ajrit nga mbetjet e gjedheve, pasi që ka lidhur marrëveshje me kompaninë regjionale të pastrimit.

### 6.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë

Në dobi të minimizimit të ndikimeve në tokë, siç është cekur edhe më lart nga ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikime në tokë. Pjesa më e madhe e sipërfaqës së parcelës ku operon therrtorja për therje të gjedheve është zone me kubëza betoni dhe pjesa tjetër ku ka lëvizje motorike poashtu është e shtruar me kubëza betoni. Ndotja e ujit mund të vijë nga larja e pajisjeve që përdoren në therjen e gjedheve dhe gjaku i tyre, mirëpo therrtorja në fjalë këto ujëra nga procesi i larjes i grumbullon dhe i dërgon në basenat (impiant) të ndërtuara nga përfaqësuesit e kompanisë në fjalë. Me pastaj mishtorja për përpunimin dhe konservimin e mishit, ujërat pas të grumbullohen në gropën septike. Për minimizimin e ndikimeve do të ndërmerren masat si në vijim:

- Ujërat që shkarkohen nga impianti për therje, duhet të grumbullohen në gropë septike, pastaj të merren nga kompania regjionale të pastrimit,

- Masa e rëndësishme për zvogëlim do të jetë edhe grumbullimi dhe trajtimi i ujerave të shkarkuar nga të gjitha objektet e impianti për therje dhe dërgimi i tyre në impiant për trajtim.
- Gjithashtu me qëllim të evitimit të ndikimeve tjera në ujëra, investitori duhet dhe do të zbatojë në përpikëri të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore dhe burimeve tjera të ujit.

### **6.3. Masat për mbrojtje nga zhurma**

Impianti për therjen e kafshëve, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij nuk shkakton zhurmë, apo mund të shkaktojë ndonjë zhurmë të vogël e cila është brenda kufijve të lejuar. Parcela ku ushtron aktivitetin e tij impianti për therje, është në afërsi të drejtpërdrejtë me rrugën që lidhë qytetin e Malishevës me Kijevën, prandaj zhurma që krijohet është thuajse me e vogël se ajo e komunikacionit, si rrjedhojë e saj zhurma nuk paraqet ndonjë shqetësim të madh. Megjithatë operatori duhet të marrë të gjitha masat e parapara sipas ligjit dhe akteve nën ligjore për parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës në kuadër të normave të lejuara, duhet të kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet të cilat prodhojnë zhurmë edhe për këtë ndikim duhet të shkurtohet në maksimum koha e mbajtjes ndezur të motorëve të mjeteve motorike, duke mirëmbajtur dhe duhet kushtuar rëndësi e veçante të gjitha pajisjeve të cilat emitojnë zhurmë gjatë procesit të punës.

### **6.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peisazh, florë dhe faunë**

Parcela në lokacionin në të cilën therrtorja për therjen e gjedheve, përpunimin dhe konservimin e mishit ushtron aktivitetin e vet, siç është cekur edhe më lart është mjaft e përshtatshme për këtë veprimtari ngase gjenden afër rrugës kryesore Malishevë – Kijevë kilometri dytë dhe është në zonën e disa vendbanimeve dhe objekteve tjera industriale, prandaj dhe nuk pritet ndikim negativ shtesë në peisazh, florë dhe faunë e lokacionit në fjalë dhe rrethit në përgjithësi.

### **6.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë**

Në afërsi të zonës së ku është e ndërtuar dhe duke ushtruar aktivitetin e saj therrtorja për therjen, përpunimin dhe konservimin e mishit është në fshatin Mirushë në qytetin e Malishevës. Në një distancë rreth 200 metra ka edhe shtëpi banimi mirëpo, mirëpo të njëjtit nuk kanë pasur deri më tani ndonjë ankese rreth aktivitetit të impianti për therjen, përpunimin dhe konservimin e mishit. Hapësirë banuese ndodhet edhe mbi katin e parë të objektit në fjalë të cilën e shfrytëzon investitori për banim personal. Investitori ka bashkëpunim të ngushtë me komunitetin lokal të zone dhe do

njofton ata me kohë për te gjitha aktivitetet e mundshme që mundë të ndikojnë në vendbanim dhe në popullatën lokale gjatë këtij aktivitetit.

#### **6.6. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore**

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve të kësaj thertore/mishtore mund të vlerësohen si raste të izoluara. Për te mos ardhur deri te ndonjë aksidenti eventual investitori i impianti për therje, duhet që të merren të gjitha masat adekuate paraprakisht. Rreziku me i madhe për ndonjë aksident vjen nga energjia elektrike si edhe pajisjet elektrike të impiantit. Për shuarjen e zjarrit të përdoren aparatet mobile zjarrfikëse që duhet të vendosen në vendet ku do të jenë me efikas. Zakonisht vendosen dy aparate mobile zjarrfikëse të tipit (S9) dhe një arkë me rërë. Në rastet kur kemi rrjedhje të vajrave dhe fluideve si mbeturina specifike që mund të ndodhin nga makinat gjatë procesit të transportit të gjedheve dhe produkteve të mishit, atëherë lëngu i derdhur duhet të pastrohet me absorbues kimik apo me ashkla të imta druri të cilat me lopata mbledhen dhe futën në fuqi ku mbahen në depo deri sa të meren nga kompanitë e licencuara për trajtimin e tyre.

#### **6.7. Menaxhimi i mbeturinave**

Gjatë operimit të impiantit për therje të gjedheve dhe përpunimin e mishit, mbeturinat që mbesin gjatë procesit të punës. Mbeturinat të cilat mbesin janë mbetjet e gjedheve dhe mbeturinat të cilat i bënë personeli gjatë procesit të punës se thertores. Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikën e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi. Për largimin e këtyre mbeturinave kompania “Shaban Spahija” B.I. ka marrëveshje me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave nga komuna e Malishevës dhe kompanitë tjera të licencuara për grumbullimin e mbetjeve.

Për mbetje të mundshme të këtij aktiviteti, zgjidhja është si në vijim:

- Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina, ndërsa
- Mbeturinat e mbetjeve të gjedheve pas therjes, do të merren nga kompania që është e kontraktuar për këtë.

## **7.0. MONITORIMI DHE RAPORTIMI**

### **7.1. Monitorimi**

Në bazë të gjendjes faktike në terren, pasi që ky aktivitet nuk paraqet trysni mjedisore, monitorim i detyrueshëm dhe permanent i treguesve mjedisor janë të domosdoshëm. Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen në mënyrë të rregullt dhe për çdo rast duhen të merren masat e nevojshme komform ligjeve dhe të njoftohen organet kompetente.

### **7.2. Raportimi**

Raportimi do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor, përkatësisht lejen mjedisore të lëshuara nga MMPHI.

## **8. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT**

Pas përfundimit të aktivitetit të thertores, pajimet e impiantit duhet të çmontohen dhe të largohen nga ky lokalitet. Bazamentet si dhe platotë duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në depononte regjionale. Struktura përfundimtare duhet të jetë e mbuluar me dheun, e cila është adekuate me dheun e mëparshëm dhe ku do të përshtatet substratit të tokës. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara apo të degraduar nga ndryshimi i destinimit do të përfshijë rivitalizimin në tërësi të hapësirës së dëmtuar nga veprimtaria ekzistuese. Zgjedhja e rikultivimit, dmth modelit, varet edhe nga qëllimi i përdorimit të tokës, siç do të jetë e paraparë me planet komunale. Prap të kthehen në funksion të tyre primar (prodhimi i biomasës), të kthehet në gjendje të përafert me ambientin rrethues dhe të mbjellen të lashtat periodike bujqëre të cilat kultivohen në rrethinën e lokalitetit, dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

## **9. KONKLUZIONE**

Duke analizuar studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masave për parandalimin e ndikimeve, intervistave e opinioneve, si dhe duke iu referuar dokumenteve ekzistuese mund të konkludojmë si në vijim:

Therrtorja për therrje e gjedheve dhe përpunimin e mishit e cila është i ndërtuar, në zonën kadastrale Mirushë, në komunën e Malishevës me pronar Shaban Spahija është në interes, të vet investitorit për të përmirësuar kushtet e punës, për të ngritur sasinë dhe kualitetin e mishit, në interes të komunës, sepse do të ketë një ndikim në rritjen e punësimit dhe të hyrave në komunë, dhe në interes të banorëve të tjerë lokal, sepse do të ofrohen mundësi e një ambienti më të menaxhuar, mundësi punësimi, si dhe produkte me cilësi të sigurt.

Në rast se mshtorja/thertorja për therjen e kafshëve dhe përpunimin e mishit, mirëmbahet në mënyrë profesionale dhe me standarde siç parashihet të mirëmbahet dhe me respektimin e plotë të masave të dhëna në këtë raport, si dhe me bashkëpunimin e plotë me autoritetet, kjo therrtoje konsiderohet krejtësisht e pranueshëm si në aspektin mjedisor, po ashtu edhe në atë social dhe ekonomik. Duke u bazuar në natyrën e thertorës dhe aktivitetit të saj, vendndodhjen e thertorës, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në mjedisin lokal janë minimale, dhe tërësisht të kontrollueshme.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit-aplikuesit “Shaban Spahija” B.I me emrin tregëtar Mishtore DRENI.



## **10. LITERATURA**

1. Plani Zhvillimor Komunal i komunës së Malishevës
3. MMPH (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013 (Vëllimi I). Prishtinë.
4. MMPH-AKMM (2008): Raport i gjendjes së mjedisit 2006-2007. Prishtinë.
5. MMPH-AKMM –IKMN (2008): Raport i gjendjes së natyrës 2006-2007. Design House. Prishtinë.
6. MMPH-AMMK (2010): Gjendja a Natyrës-Raport 2008-2009. UNDP. IN Design Prishtinë.
7. MMPH-IHMK – Buletini Hidro-Klimatologjik 2016,
8. MMPH\_IHMK – Resurset Ujore te Kosves 2015,
9. MMPH-IHMK – Vjetari Hidrometerologjik 2014,
10. mmph-rks.org/Ligjet 15. Osmani, J. (2008): Vendbanimet e Kosovës.

## **11. Shtojcë**

### **Bashkëngjitur këtij raporti gjeni:**

- Certifikata e regjistrimit të biznesit,
- Te dhënat për biznesin,
- Certifikatat e pronës,
- Kopja e planit,
- Situacioni i terenit
- Njoftimi komunal